



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



TV HERC
Bojan MLADENVIÇ
Drejtor
Shtërpe

Ankesa Nr. 2015/43
Ref: 1510/1281/KPM/am

VENDIM

Lidhur me Ankesën Nr. 2015/43 - Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër TV HERC (“Pala Përgjegjëse”)

Faktet

1. Pala Përgjegjëse me datë 6 tetor 2009, është pajisur me licencë të KPM-së. Me marrjen e Licencës Pala Përgjegjëse është obliguar që të respektojë Ligjin e KPM-së, Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele KPM-2013/01, si dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM.
2. KPM, me datën 8 korrik 2015, ka bërë monitorimin e Palës Përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren KPM-2013/01. Nga monitorimi është gjetur se Pala Përgjegjëse është në shkelje të Rregullores KPM-2013/01, pasi që filmat e transmetuar nuk i ka paralajmëruar para fillimit të programit dhe nuk i ka kategorizuar me shenjat përkatëse, siç është paraparë me Rregulloren KPM-2013/01.
3. KPM, bazuar në shkeljen e Rregullores KPM-2013/01, nga ana e Palës Përgjegjëse, me datën 28 korrik 2015, i ka dërguar Njoftim për Shkelje, me të cilin e ka udhëzuar që të veprojë në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/01, në të kundërtën Zyra Ekzekutive e KPM-së do t'i rekomandojë Komisionit të KPM-së të ndërmarrë masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse.
4. KPM, pas dërgimit të Njoftimit për Shkelje, me datën 2 shtator 2015, ka bërë monitorimin e dytë të Palës Përgjegjëse. Nga monitorimi i bërë vërehet se Pala Përgjegjëse, edhe përkundër Njoftimit për Shkelje, vazhdon të jetë në shkelje të Rregullores KPM-2013/01, duke mos i paralajmëruar dhe kategorizuar filmat e transmetuar.

Analiza Ligjore

5. Komisioni, bazuar në faktet e lartpërmendura konkludon se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 3, paragrafi 3, nenit 5, paragrafi 3 dhe nenit 6, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2013/01.

Neni 3, paragrafi 3, i Rregullores KPM-2013/01 përcakton:

"Subjektet transmetuese të cilat transmetojnë TV programe me përmbajtje të dëmshme për fëmijët, obligohen që ato programe t'i paralajmërojnë me sinjal akustik apo tekstual dhe t'i identifikojnë me simbolin përkatës vizual gjatë tërë kohëzgjatjes së tyre, sipas kategorizimit të programeve në këtë rregullore."

Neni 5, paragrafi 3, i Rregullores KPM-2013/01 përcakton:

"Kategoria e tretë përfshin programet, që përmbajnë skena dhune dhe frike, si dhe përmbajtje erotike, të cilat përsëriten relativisht shpesh. Këto përmbajtje të dëmshme programore nuk rekomandohen për fëmijët nën moshën 14 vjeçare. Për programet e kategorisë së tretë prania e prindit, kujdestarit, është e domosdoshme. Transmetimi i këtyre programeve duhet të paralajmërohet dhe të shoqërohet me shenjë përkatëse."

Neni 6, paragrafi 3, i Rregullores KPM-2013/01 përcakton:

"Transmetimi i programeve, që i takojnë kategorisë së tretë, mund të bëhet prej orës 22:00 deri në ora 06:00."

6. Komisioni, bazuar në raportet e monitorimit ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 3, paragrafi 3, nenin 5, paragrafi 3 dhe nenin 6, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2013/01, pasi që nuk i ka paralajmëruar dhe nuk i ka kategorizuar filmat të cilët i ka transmetuar.
7. Komisioni, duke u bazuar në raportet e monitorimit ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka dështuar që të marrë hapa të nevojshëm për të ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/01, pasi që ka dështuar t'i paralajmërojë dhe t'i kategorizojë filmat e transmetuar.
8. Komisioni, bazuar në raportin e monitorimit ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër Njoftimit për Shkelje të dërguar nga KPM, përmes së cilit i është bërë me dije se është në shkelje të Rregullores KPM-2013/01, nuk i ka paralajmëruar dhe kategorizuar filmat e transmetuar.
9. Komisioni, duke u bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura vlerëson se, Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 3, paragrafi 3, nenit 5, paragrafi 3 dhe të nenit 6, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2013/01, pasi që ka transmetuar filma pa i paralajmëruar para fillimit të tyre dhe pa i kategorizuar.

Vendimi


10. Komisioni, bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konkludon se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 3, paragrafi 3, nenit 5, paragrafi 3 dhe nenit 6, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2013/01, pasi që ka transmetuar filma pa i paralajmëruar para fillimit të tyre dhe pa i kategorizuar.
11. Komisioni vendosi që në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, Pala Përgjegjëse të sanksionohet me Vërejtje për shkelje të vazhdueshme të nenit 3, paragrafi 3, nenit 5, paragrafi 3 dhe nenit 6, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2013/01.
12. Pala Përgjegjëse obligohet që të respektojë Rregulloren KPM-2013/01, të bëjë kategorizimin dhe paralajmërimin e filmave që i transmeton. Dështimi i Palës Përgjegjëse që edhe pas kësaj Vërejtjeje të veprojë në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/01, do të rezultojë me masa tjera ligjore, në pajtim me nenin 30 të Ligjit të KPM-së.

E drejta për Ankesë

13. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
14. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

Lëshimi i Vendimit

Komisioni e lëshon këtë vendim



Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



27.10.2015

datë

1289.

Lloji i dërgesës _____
Vrsta pošiljke _____

Vlera e cekur - Shuma e dërguar _____
Oznaçona vlerdnost - poslani iznos _____


nën numër _____
pod br. _____

për _____
za _____

TV HERC - BOŠAN MLADENVIĆ
ŠTERPCE

(Vendi)
(Mesto)

Poshtë i nënshkruari deklaron që dërgesa e cekur (shuma e dërguar) është dorëzuar në rregull (paguar me datë) _____ 31-10-2015
Dole potpisani izjavljuje da je pomenuta pošiljka (poslani iznos) predata uredno (placena dana)

Nënshkrimi i marrësit
Potpis primaoca


Vula e postës së vendit
Peçat pošte



Nënshkrimi i nënpunësit
të postës së vendit
Potpis radnika pošte

